

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"Elixir Life" SH.P.K

Sot më datë 17.12.2024, u paraqitën palët e mëposhtme:

- **Z. Shimon Meshi**, shtetas Izraelit, lindur në Jerusalem më 16.02.1994, dhe me vendbanim në Jerusalem mbajtës i pasaporta nr 40115264 dhe nr ID 3-1228890-5, me zotësi të plotë për të vepruar dhe kuptuar
- **Z.Mats-Erik Anders Pistol** shtetas suedez, lindur ne Suedi me 11.12.1957, dhe me vendbanim në Lund mbajtës i pasaporta nr.AA3884389 zotësi të plotë për të vepruar dhe kuptuar
- **Shoqëria "Dea 2 Sh.p.k"** me nipt M42029002U, me adresë ruga Vidhe Gjata 16, MezezKashar, Km 1, Autostrada TR-DR, Tirane 1001, Tiranë me administrator **Z. Olti Peçini**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 19.08.1977, dhe me vendbanim në Tiranë, mbajtës i pasaporta nr BF9785287 dhe numër personal H708191770 me zotësi të plotë për të vepruar dhe kuptuar

Të cilët kanë vendosur të nënshkruajë Statutin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjesi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

KAPITULLI I
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1— Forma

- 1.1 Shoqëria "**Elixir Life**" Sh.p.k. (në vijim "Shoqëria") krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti.
- 1.2 Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3 Statuti është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çeshtjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 — Emërtimi

- 2.1 Emërtimi i Shoqërisë është "**Elixir Life**" SH.P.K

Neni 3 — Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin shqiptar. Në mënyrë më specifike, shoqëria ka si objekt të aktivitetit të saj: Kërkimin dhe prodhimin e produkteve farmaceutike dhe ilaçeve; materialeve dhe pajisjeve mjekësore në përgjithësi; ofrimin e shërbimeve spitalore; menaxhimin dhe ndërtimin e laboratorëve molekularë, gjenetikë, kërkimorë dhe jo-kërkimorë në territorin e Republikës së Shqipërisë; zhvillimin e trajnimeve dhe kërkimeve shkencore në fushën e mjekësisë precize; ndërtimin, blerjen, menaxhimin dhe shitjen e pasurive të paluajtshme edhe për përdorime të ndryshme nga sa më sipër; Menaxhimin dhe/ose ndërtimin e strukturave për formimin e mjekëve dhe paramjekëkeve; Import-eksport dhe tregëtimin e çdo lloj pajisjeje mjekësore, laboratorike, farmaceutike dhe të pajisjeve të mirëmbajtjes shëndetësore; Furnizimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të kategorive të mësipërme; Menaxhimin e shërbimeve komplementare për aktivitetet si më lart, si shërbimeve projektimi, ndërtimi dhe të implementimit të ndërtimit, laboratorike, shërbimeve mjekësore, studimeve biologjike dhe gjenetike.



Neni 4 — Selia

- 4.1 Selia e Shoqërisë është në Rruga Vidhe Gjata 16, Mezez, Kashar, Km 1, Autostrada TR-DR, Tiranë, Shqipëri.
- 4.2 Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- 4.3 Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si dhe jashtë saj.

Neni 5 — Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.
- 5.2 Shoqëria mund të shpërbëhet përpara këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblese së Ortakëve.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6 — Kapitali themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100'000.00 (njëqind mijë) Leke.
- 6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100.000 kuota të ndara në para, me vlerë nominale të një aksioni të barabartë me 1 lek.

6.3 Neni 7 - Kontributet

- 7.1 Sipas kontributeve aksionet e kompanisë janë si më poshtë :
- **Z. Shimon Meshin** është zotërues i 40'000.00 aksioneve të cilat përfaqësojnë 40% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - **Z. Mats-Erik Anders Pistol** është zotërues i 30'000.00 aksioneve të cilat përfaqësojnë 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë
 - **Subjekti Dea 2 Shpk** është zotërues i 30'000.00 aksioneve të cilat përfaqësojnë 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë

Neni 8 — Rritja e kapitalit themeltar

- 8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të cilesuar të Asamblese së Ortakëve sipas ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare
- 8.2 Në rast të rritjes të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejten të nënshkruajnë rritjen në raport me pjesët e kapitalit të zotëruara. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 9 — Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblese së Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogelohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.

for *Mats-Erik Pistol*

Neni 10 — Transferimi i kuotave

- 10.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, aksionet duhet me parë t'i ofrohen në parablerje ortakeve të tjerë.
- 10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotën e tij duhet të njoftojë ortakët e tjerë me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit.
- 10.4 Ortakët do të kenë të drejtën e 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, vendimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar prej 15 ditësh, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e ofruara nga ortaku që transferon kuotat do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në çdo rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve me mbi 51% të ortakëve të shoqërisë.

KAPITULLI III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

Neni 11 — Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

- 11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve
- 11.2 Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështje të mëposhtme: ndryshimet e statutit, emërimin dhe shkarkimin e administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, rritjen dhe uljen e kapitalit, transferimin e kuotave, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe shpërbërjen e shoqërisë, miratimin e bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo ligji Nr.9901 datë.14.04.2008 për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

Neni 12 — E drejta e pjesënarrjes dhe e votës

- 12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave që ai zotëron.
- 12.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.

Neni 13 — Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet

- 13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.
- 13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve si dhe prej një ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve



— në adresën e ortakëve ose nëpërmjet emailit në adresën elektronike të secilit ortak dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.

13.3 Asambleja e ortakëve mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë.

13.4 Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mblidhet me thirrjen e parë për mungesën e kuorumit të parashikuar në piken 13.7 të këtij Statuti, Asambleja e Ortakëve do të thirret brenda 30 (tridhjetë) ditëve me të njëjtin rend dite.

13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të nderhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë edhe në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.

13.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të gjithë kapitalin themeltar.

13.7 Vendimet e Asamblese së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zoterojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblese së Ortakëve që kërkojnë një shumicë të cilesuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zoterojnë të paktën 51 % (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar.

13.8 Asambleja e Ortakëve vendos ndryshimet e statutit, rritjen dhe uljen e kapitalit, transferimin e kuotave, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, me votën pro të 3/4 (tre të katërtave të kuotave) të kapitalit themeltar. Në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Ortakëve merr vendime me shumicë të thjeshtë votash të ortakëve që zoterojnë me shumë se 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar.

13.9 Për vendime të rëndësishme si ndryshimi i statutit, rritja ose ulja e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 për Entitetet Tregtare, Asambleja vendos me tre të katërtat e votave të aksionarëve pjesëmarrës, përveç nëse statuti kërkon një shumicë më të lartë. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të këtij ligji, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës. Vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

13.10 Çdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.

13.11 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.

Ante - Eni Patel

13.12 Asambleja e ortakëve krijon dhe emëron Bordin e Drejtorëve për të udhëhequr linjat e zhvillimit të shoqërisë të cilat më pas i transmetohen administratorit për zbatim. Asambleja e ortakëve zgjedh drejtorët dhe përcakon kompensimin e tyre nëpërmjet një votimi të kualifikuar. Bordi i Drejtorëve mbledhet të paktën një herë në muaj qoftë fizikisht apo elektronikisht. Aktet e Bordit Drejtues mbahen në zyrat e kompanisë. Individët e mëposhtëm emërohen si drejtorë dhe anëtarë të bordit drejtues: **Z. Mats-Erik Anders Pistol** shtetas suedez, lindur në Suedi më 11.12.1957, dhe me vendbanim në Lund mbajtës i pasaporta nr. AA3884389; **Z. Shimon Meshi**, shtetas Izraelit, lindur në Jerusalem më 16.02.1994, dhe me vendbanim në Jerusalem mbajtës i pasaporta nr 40115264 dhe nr ID 3-1228890-5 ; **Z. Olti Peçini**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 19.08.1977, dhe me vendbanim në Tiranë, mbajtës i pasaporta nr BF9785287 dhe numër personal H708191770.

Neni 14 — Administrimi

14.1 Shoqëria administrohet nga të paktën 1 (një) Administrator i cili do të qëndrojë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë prej 3 (tre) vitesh. Administratori caktohet nga asambleja. Administrator i shoqërisë emërohet **Z. Olti Peçini**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 19.08.1977, dhe me vendbanim në Tiranë, mbajtës i pasaporta nr BF9785287 dhe numër personal H708191770

14.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori mund të ushtroj të gjitha fuqitë konform me sa parashikohet në nenin 95 të Ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*".

14.3 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.

14.4 Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

14.5 **Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:**

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme
- b) përfaqëson shoqërinë tregtare para qeverisë dhe entiteteve të tjera ligjore;
- c) siguron mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

14.6 Shpërblimi

- a) Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme.
- b) Shpërblimi, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.
- c) Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.
- ç) Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

Neni 15 — Audituesi Ligjor

- 15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 15.2 Audituesi ligjor mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BALANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 16.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor të secilit vit.
- 16.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendren Kombetare të Regjistrimit dhe përfundon me 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligji n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare"
- 16.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 17 – Fitimet

- 17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjeset e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 17.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

KAPITULLI V

SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 18 — Prishja

- 18.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga Ligji, ose me anë të një vendimi të asamblese së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.
- 18.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

Neni 19 — Likuidimi

- 19.1 Në rast shpërbërjeje, shoqëria do të kalojë në fazën e likuidimit.
- 19.2 Për ta administruar këtë procedure, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe ato që mund të lindin në pergjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtperdrejte ndërmjet palëve të interesuara.



20.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ORTAKËT E SHOQËRISË

Dea 2 Sh.p.k

Z.Mats-Erik Anders Pistol

Z.Shimon Meshi



Mats-Erik Pistol



shimon meshi